



Programi i praktikës

Mundësi për punë praktike

Banka ProCredit është një institucion që vlerëson shumë përgjegjësinë sociale dhe profesionalizmin në të gjitha fushat. Si pjesë e kontributit tonë në përpjekjet për arsimimin financiar të vendit ne ofrojmë mundësi për punë praktike dy herë në vit (në baza semestrale). Ne nuk jemi duke u ofruar studentëve mundësi vetëm për të përmbushur kërkesat e tyre universitare, por ne gjithashtu jemi duke u ofruar atyre një mundësi për t'u bërë pjesë e një institucioni etik që i është dedikuar përgjegjësisë bankare.

Banka ProCredit i fton të gjithë studentët të cilët i plotësojnë kriteret e shënuara më poshtë që të aplikojnë për praktikë gjatë sezonit veror në Bankën ProCredit.

Studentët e përzgjedhur, do të caktohen në një nga rajonet ku operon Banka ProCredit (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan) për një periudhë prej një deri në tre muaj dhe gjatë kësaj periudhe ata do të pranojnë pagë.

Ne jemi duke kërkuar studentë të cilët:

- › Janë të gatshëm për të mësuar dhe të cilët janë në gjendje të përshtatën në mjediset e reja.
- › Kanë investuar në studimet e tyre dhe të cilët janë të orientuar drejt zhvillimit profesional.
- › Kanë aftësi që të kuptojnë dhe komunikojnë me klientët tanë.
- › Janë të gatshëm dhe në gjendje të marrin përgjegjësi dhe të marrin vendime në bazë të arsyes, logjikës dhe sensit të përbashkët.
- › Janë të ndershëm dhe të besueshëm, të aftë për të trajtuar informacionin konfidencial me diskrecion.
- › Janë entuziast për të kontribuar në objektivat tona.

Kriteret e përshtatshmërisë për programin e praktikës:

- › Studentët duhet të jenë në vitin e fundit ose të parafundit të studimeve të tyre.
- › Nota mesatare (GPA) të jetë 7.5 respektivisht 2.5 e më lart (dëshmia është e detyrueshme kur të ftoheni për intervistë individuale).

Ne ofrojmë punë praktike interesante dhe sfiduese në një ambient ndërkombëtar e dinamik, të karakterizuar me kulturë të hapur komunikimi. Për të aplikuar për praktikë, ju duhet të plotësoni **APLIKACIONIN ONLINE** së bashku me një **LETËR MOTIVIMI** duke klikuar **KËTU**.

Dokumentet tuaja të aplikimit duhet të tregojnë qartë arsyen se pse ju jeni pikërisht të përshtatshëm për programin e praktikës. Është shumë e rëndësishme për ne të dimë motivin tuaj për t'u bashkuar me ekipin tonë. Prandaj, ne ju rekomandojmë që të lexoni për ProCredit para fillimit të përgatitjes së CV-së tuaj dhe letrës së motivimit.

Për më shumë informata në lidhje me grupin ProCredit në gjithë botën, mund të gjeni në faqen tonë të internetit <http://www.procreditbank-kos.com/sq/Ballina> dhe në faqen e internetit të kompanisë sonë mëmë <http://www.procredit-holding.com/en/>.

Në letrën e motivimit, ju duhet të shpjegoni qartë arsyet tuaja për aplikim. Një letër e mirë-strukturuar dhe me motiv të sinqertë është me rëndësi jetike - ne analizojmë të gjitha letrat e motivimit me kujdes të lartë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 31.Maj.2017